

STATUT I SHOQERISE "LIZ" SHPK

Titulli I

Data e themelimit, Emertimi, Objekti, Kohezgjatja, Zyra Qendrore, Forma e shoqerise, Vula e shoqerise

Neni 1: Data e themelimit, Emertimi dhe Themeluesit

Shoqeria "LIZ" SHPK krijohet ne date 23.03.2021 nga ortaku si me poshte :
Linditë Dushku e bija e Qamil, dtl. 18 Dhjetor 1984, Shtetase e Kosoves ,banues ne Korce, Lagja 18 ,Rruga 1 Maji , Nr3 sipas Lejes se Qendrimit Tipi B.
Ne baze te akt themelimit te dates 16 Mars 2021, znj. Lindite Dushku, madhore, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, identifikuar me Pasaporte me nr. P00410884:

Neni 2: Personaliteti juridik

2.1 Shoqeria eshte person juridik shqiptar.

2.2 Shoqeria gezon te drejta si person juridik shqiptar, qe prej dates ne te cilen kryhet regjistrimi i saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

2.3 Shoqeria e ushtron aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara ne dokumentet themeluese (Akt Themelimi dhe Statut).

Neni 3: Forma e shocierise

3.1 Shoqeria do te kete formen e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, derisa me vendim te Asamblese se Pergjithshme te vendoset shnderrimi i formes ligjore.

Neni 4: Objekti

4.1 Shoqeria "LIZ" SHPK do te kete si objekt te veprimtarise:

- Prodhim dhe tregtim, Import- eksport me shumice dhe pakice te mallrave te ndryshem si detergjente, artikuj kozmetike, lende te para dhe ndihmese per kete industri, pajisje, makineri, dhe linja prodhimi, veprimtari ne fushen e transportit te mallrave dhe te udhetareve, veprimtari ne fushen e ndertimit, sherbim konsulence per vete dhe te

trete ne marketing, si dhe tregti me shumice dhe pakice te artikujve te ndryshem industrial te papermendur ne menyre specifike me larte .

- Shtëpi botuese , import export. Në fushën e botimit të librit si dhe tregtim i librit,. Investime e pjesmarrje në investime, ndërtime në fushën e turizmit, hoteleri, objekte, social kuturore, shtetërore e private.
- Cdo veprim tjetër financiar e tregtar që lidhet ne menyre te drejteperdrejte ose terthorazi me objektin e veprimtarise dhe që eshte ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Neni 5: Kohezgjatja

5.1 Shoqeria "LIZ" SHPK kryen veprimtarine e saj tregtare per nje periudhe kohore te pacaktuar derisa te vendoset ndryshe nga Asambleja e Pergjithshme.

5.2 Shoqeria fiton personalitetin juridik ne daten e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe nga kjo date ajo mund te filloje te ushtroje aktivitetin tregtar den i kur me nje vendim te Asambleja e Pergjithshme te vendoset prishja e shoqerise ose kur shoqeria mbaron ne nje nga menytrat e parashikuara ne ligjin "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

Neni 6: Selia

6.1 Selia kryesore e shoqerise do te jete ne Tirane, Yzberish, Rruga Astrit Losha, 299/221-N7. Me vendim te Administratorit selia e shoqerise mund te ndryshohet, mund te hapen dege, dhe zyra perfaqesimi te saj brenda dhe jashte Shqiperise.

Neni 7: Vula e Shocierise

7.1 Shoqeria do te kete vulen e saj duke shenuar ne te emertimin tregtar ose iniciale.

Titulli II Kapitali

Neni 8: Kapitali Themeltar

8.1 Kapitali themeltar i shoqdrise do te jete 1000 (Nje mije) Leke, i zoteruar nga ortakët si me poshte:

Emri, Mbiemri	% qe zoteron	Kuotat qe zoteron
---------------	--------------	-------------------

Linditë Dushku	100 %	1 kuote
----------------	-------	---------

8.2 Ky kapital eshte i ndare ne 1 (nje) kuote te zoteruar 100% nga ortaku i vetem sipas tabelës me siper. Ortaku themelues Lindite Dushku, zoteron 1 kuote, me vlere te pergjithshme 1000 Leke, qe perben 100 % te kapitalit themeltar.

8.3 Kapitali themeltar do te depozitohet ne nje Banke ne Shqiperi me nje llogari te hapur ne emer te shoqerise ne formim e siper ose ne arken e shoqerise.

Neni 9: Kuotat, te drejtat e lidhura me to

9.1 cdo kuote jep te drejten e nje vote per te mare vendime sipas ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqdrite Tregtare".Te gjitha votat do te ushtrohen nga ortaket sipas zoterimeve.

Neni 10: Kuotat. Fitimi, Transferimi i kuotave

10.1 Kuotat e kapitalit te shoqerise mund te fitohen nepermjet kontributit ne kapitalin e shoqerise, shitblerjes, trashigimise, dhurimit, apo cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Titulli III Asambleja e Pergjithshme

Neni 11: Asambleja e Pergjithshme. Thirrja e mbledhjes. Marrja e vendimeve. E drejta e votes

11.1 Asambleja e Pergjithshme, si organ kryesor i shoqerise sipas ligjit "Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare" perfaqesohet ne kete shoqeri nga ortaket.

11.2 Asambleja e Pergjithshme thirret me shkrese jo me vone se 7 (shtate) dite perpara dates se mbledhjes, ne adresat e percaktuara ne dispoziten "Njoftimet" me poshte. Njoftimi duhet te permbaje: ditën, orën, vendin ku do te mbahet mbledhja si dhe rendin e dites. Njoftimi behet nga Administratori i shoqerise apo nga cdo ortak i cili perfaqeson te pakten 5% (pese perqind) te totalit te votave ne Asamblene e Pergjithshme.

11.3 Asambleja e Pergjithshme duhet te thirret te pakten nje here ne vit per te vendosur per ceshtje te tilla si miratimi i bilancit dhe pasqyrave financiare, miratimi i raportit te auditimit te shoqerise.

11.4 Mbledhjet mbahen ne seline e shoqerise, apo edhe ne nje vend tjeter te njohur nga ortaku i vetem.

11.5 Vendimet merren nga Asambleja e Pergjithshme.

Neni 12: Kompetencat e Asamblese

12.1 Asambleja e Pergjithshme eshte kompetente per marrjen e vendimeve per shoqerine ne lidhje me ceshtjet e meposhtme:

- 1.Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- 2.Ndryshimin e Statutit;
- 3.Emerimin/shkarkimin e Administratorit, eksperteve kontabel, likujdatoreve;
- 4.Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga Administratoret pershire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- 5.Miratimin e pasqyrave finaciare dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- 6.Shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- 7.Kryerjen e kontroll-revizionit financiar te shoqdrise me eksperte te caktuar prej saj;
- 8.Te vendose per zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- 9.Te vendose per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- 10.Ceshtje te tjera qe jane te rendesishme per aktivitetin tregtar te shoqerise.

Neni 13: Perfaqesimi ne Asamble

13.1 Ortaku mund te perfaqesohet ne mbledhje, ne rastet kur e ka te pamundur pjesemarrjen personalisht ne mbledhje, nga nje person i trete ose edhe nga nje ortak tjeter shoqerie. Autorizimi duhet te kete te percaktuar qarte kompetencat e perfaqesuesit si dhe te drejtat e tij lidhur me vendimarrjen ne mbledhje.

Titulli IV Administratori

Neni 14: Administrimi i shoqerise

14.1 Shoqeria administrohet nga nje Administrator i zgjedhur nga Asambleja e Pergjithshme . Administrator i shoqerise do te jete Znj. Linditë Dushku e bija e Qamil, dtl. 18 Dhjetor 1984, Shtetase e Kosoves ,banues ne Korce, Lagja 18 ,Rruga 1 Maji , Nr3 sipas Lejes se Qendrimit Tipi B. Afati i ushtrimit te detyres eshte 5 (pese) vjet me te drejte riperteritje.



Neni 15: Te drejttat dhe detyrimet e Administratorit. Pergjegjesite

15.1 Administratori ushtron kompetencat e meposhtme:

1. Kryen te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise duke zbatuar politikat tregtare te vendosura nga Asambleja e Pergjithshme;
2. Vepron me te tretet ne emer dhe per llogari te shoqerise brenda kompetencave te parashikuara ne statut apo/dhe ne ligjin "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".
3. Kryen emerimin dhe shkarkimin nga puna te punemarresve te shoqerise.
4. Jep urdhra dhe udhezime punemarresve dhe vendos sanksione ndaj tyre, ne perputhje me kontratat e punes dhe rregulloret e brendshme te shoqerise;
5. Drejton dhe organizon punen ne menyre te tille qe te siguroje suksesin e shoqerise ne veprimtarine e saj ekonomiko-financiare;
6. Te raportoje para Asamblese se Pergjithshme sa here qe Asambleja e kerkon si dhe ne rastet kur eshte i nevojshem raportimi ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare.
7. Te zbatoje vendimet e marra nga Asambleja e Pergjithshme;
8. T'i paraqese ne menyre te rregullt dhe ne kohe te pershtatshme Asamblese se Pergjithshme, raportin e administrimit, inventarit, bilancin dhe llogarite vjetore si dhe te pergjigjet per to.
9. Te ushtroje te drejta dhe detyrime te tjera te percaktuara nga ligji Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".
10. Administratori eshte pergjegjes ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjit dhe statutit dhe per faje te kryera gjate administrimit sipas parashikimit te ligjit nr. 9901 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe ligjeve te tjera ne fuqi.

Neni 16: Mbarimi i mandatit te Administratorit

16.1 Mandati i Administratorit perfundon:

- me mbarimin e afatit;
- me shkarkimin e tij nga Asambleja e Pergjithshme;
- kur vete Administratori jep doreheqjen vullnetarisht.



-sipas menyrave te tjera parashikuar nga ligji "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

Titulli V

Viti Financiar. Prishja e Shoqerise. Dispozitat e fundit.

Neni 17: Viti Financiar

17.1 Veprimet financiare mbyllen me 31 dhjetor te cdo viti. Administratori merr masa lidhur me nxjerrjen e bilancit te hartuar konform ligjit mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

Neni 18: Mbarimi i Shoqerise

18.1 Shoqeria "LIZ" SHPK mbaron:

- 1.Me vendim te Asamblese se Pergjithshme;
- 2.Me hapjen e procedurave te falimentimit;
- 3.Sipas shkaqieve te tjera te parashikuara nga ligji "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

Neni 19: Njoftimet

19.1 Njoftimi per ortakun duhet te kryhet sipas adreses se percaktuar ne Nenin 6 te ketij statuti.

19.2 Ortaku eshte i detyruar te njoftoje ndryshimet ne adresen e tij.

Neni 20: Te ndryshme


20.1 Per ceshtje qe nuk parashikohen dhe rregullohen shprehimisht nga ky statut, gjejne referim dispozitat e Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".



20.2 Shoqeria "LIZ" SHPK regjistrohet sipas neneve 26, 28, 32 e 35 te ligjit nr. 9723,
date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" 20.3 Statuti u hartua ne 3 (tre) kopje
ne gjuhen shqipe me vlere te njejte juridike.

THEMELUES

Linditë DUSHKU

Linditë Dushku


Akt Thmelimi

I shoqerise tregtare "LIZ" sh.p.k

Mbeshtetur ne Kushtetuten dhe Kodin Civil ne Fuqi te Republikes se Shqiperise , ne ligjin Nr.7512 date 10.08.1991 " Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private , nismes se lire dhe te veprimtarise private dhe privatizimit" , te ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 , " Per shoqerite tregatre" dhe te ligjit Nr.9723 , date 03.05.2007 "Per Q.K.R dhe formalitetet qe duhe respektuar nga Shoqerite Tregtare , me vullnetin e tij te lire , te shprehur edhe ne nenshkrimin e ketij akt-themelimi ne ortaket :

Sot dat 16.03.2021 une Linditë Dushku e bija e Qamil, dtl. 18 Dhjetor 1984, Shtetase e Kosoves ,banues ne Korce, Lagja 18 ,Ruga 1 Maji , Nr3 sipas Lejes se Qendrimit Tipi B, krijoje shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar "LIZ" sh.p.k me akt themelimi si vijon :

Formulimi

Neni 1

Formohet shoqeria tregtare private e quajtur LIZ sh.p.k . Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqipetar , ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline dega . Shoqeria do te ushrje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaket themelues .

Selia e Shoqerise

Neni 2

Selia e shoqerise tregtare private "LIZ" sh.p.k do te kete seline ne Tirane, Yzberish, Ruga Astrit Losha, 299/221-N7 .Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj , te hape zyra perfaqesie , dege , te krijoje filiale si brenda ashtu dhe jashte Republikes se Shqiperise , vetem me vendim te asamblese dhe ortakut te vetem .

Objektivi I Veprimtarise

Neni 3

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne fushat e :

Prodhim dhe tregtim, Import- eksport me shumice dhe pakice te



mallrave te ndryshem si detergjente, artikuj kozmetike, lende te para dhe ndihmese per kete industri, pajisje, makineri, dhe linja prodhimi, veprimtari ne fushen e transportit te mallrave dhe te udhetareve, veprimtari ne fushen e ndertimit, sherbim konsulence per vete dhe te trete ne marketing, si dhe tregti me shumice dhe pakice te artikujve te ndryshem industrial te papermendur ne menyre specifike me larte .

- Shtëpi botuese , import export. Në fushën e botimit të librit si dhe tregtim i librit,. Investime e pjesmarrje në investime, ndërtime në fushën e turizmit, hoteleri, objekte, social kuturore, shtetërore e private.
- Cdo veprim tjetër financiar e tregtar qe lidhet ne menyre te drejteperdrejte ose terthorazi me objektin e veprimtarise dhe qe eshte ne perputhje me legjislacionin ne fuqi

Kohezgjatja e Shoqerise

Neni 4

Kohezgjatja e shoqerise do te jete me nje afat 10-vjecar . Ajo mund shperbehet ne cdo kohe dhe per cfardo lloj shkaku .

Kapitali I Shoqerise

Neni 5

Kapitali fillestar I shoqerise private "LIZ" sh.p.k do te jete 1.000 (Nje mije leke). Kapitali eshte 100% nga kuotat e ortakut te vetem , e ndare ne 1000 kuota . Kapitalui themeltar fillestar mund te shtohet ose te pakesohet (por jo nen vleren e kapitalit themeltar fillestar).

Drejtimi I Shoqerise

Neni 6

Shoqeria do te drejtohet nga administratori I saj , ortakut I vetem ortakut I vetem dhe perfaqesuesi ligjor

I saj . Ai eshte perfaqesuesi I Shoqerise ne marredhenie me te tretet dhe ka kompetenca te plota ne drejtimin e saj .

Cdo kontrate do te kryhet prej tij dhe ne rast mungese nga nje perfaqesues I pajisur me prokure te posacme .

Neni 7

Te ardhurat neto te shoqerise I takojne ortakut te vetem .

Neni 8

Ortaku I vetem themelues ka te drejte te emeruje dhe administratore te tjere te vlerave materiale
Ka te drejte te caktoje financiere , likuidator per problemet e shoqerise si dhe te pajtoje persona te tjere
si ortake .

Neni 9

Konfliktet qe mund te lindin do te zgjidhen ne zbatim te legjislacionit Shqiptar ne Gjykatën e Rethit Gjyqesor Tirane .

Neni 10

Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme , me tekstin rreth saj .

Neni 11

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi dhe vecanerisht te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Krijimin e Shoqerive Tregtare" , si dhe duke zbatuar ligjet nderkombetare dhe te vendit si dhe rregullave qe zbatohen per biznesin qe kryen kjo shoqeri .

Neni 12

Akti I themelimit u perpilua ne 2 kopje , per t'ju shperndare organeve kompetente dhe nje kopje do te mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise "LIZ" sh.p.k
Akti I themelimit nenshkruhet rregullisht nga ortaku I vetem .

**Ortak i vetem themelues i
LIZ sh.p.k
Linditë Dushku**

Linditë Dushku

